



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.700/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë, në seancën e panelit të mbajtur me 06.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 29.12.2010 nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se me datën 28.12.2010 rreth orës 16:00 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve vëzhguesit e tyre kanë hasur në parregullsi gjatë rinumërimit të votave. Në kutin e vendvotimit 2027a/01R, në listën e votuesve kishte më shumë se 5 nënshkrime që rezultojnë identike (në formë të tikut) gjë që nuk është dashur të numërohen, mirëpo njeri nder zyrtarët e QNR-ës me emrin Visar Shala thotë “ska lidhje procedoje si të rregullt“ 107 vota sipas vëzhguesit tonë janë të nënshkruara me një nënshkrim të njëjtë. Me këtë rast QNR nuk i ka dërguar këto parregullsi për hetim ose auditim.

Neni 106 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së, specifikon se:

106.1 “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasën votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jete vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”.

106.2 "Para certifikimit te rezultatit te zgjedhjeve, KQZ-ja mund te urdhërojë rinumërimin e votave ne cilindo vendvotim, qendër te numërimit ose edhe përsëritjen e votimit ne një qendër votimi apo ne një komune".

Neni 4.2 i Rregullave dhe Procedurave te PZAP parasheh si vijon:

4.2 PZAP-i mund t'i hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pasafatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore. Në rast se ankesa nuk i plotëson këto kriteret, PZAP-i mund t'i japë palës ankuese një periudhë të arsyeshme kohore, siç është paraparë në njoftim, për t'i plotësuar ato kriteret.

PZAP gjeti se:

- **ankesa është e palejuar**

Bazuar ne vendimin e PZAP-it me numër të lëndës A-490 te dt. 16.12.2010, KQZ-ja ne përputhje me nenin 106. 2 te LPZ, ne dt. 16.12.2010 urdhërojë përsëritjen e votimit ne komunën e Glllogocit, Deçanit dhe Skenderaj. Gjithashtu KQZ-ja ka urdhëruar përsëritjen e votimit ne QV 1304E ne komunën e Lipjanit dhe QV 3008A ne komunën e Malishevës. Si rrjedhim i përsëritjes se votimit në këto komuna dhe vendvotime, rezultatet preliminare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës mund të ndryshojnë. Duke vlerësuar se rinumërimi ka përfunduar dhe se procesi zgjedhor nuk do te konsiderohet i përfunduar deri ne momentin që rivotimi të jetë kryer, si dhe në kuptim të nenit 106.1 te LPZ-se certifikimi i rezultateve preliminare është i pa përfunduar, PZAP gjykon se ankesa e subjektit politik LVV, nuk është e lejuar. Prandaj ne këtë faze te procedurës, interesi ligjor i palës mund te ndryshoj ne varësi sipas shpalljes se rezultateve nga QNR si pasoje e vendimit te KQZ-se si dhe për parregullsitë e pretenduara do të bëhet auditimi paralelisht me futjen e bazës së të dhënave në sistem. Prandaj PZAP gjykon se ankesa e subjektit politik LVV ne këtë faze te procedurës se procesit zgjedhor është e parakohshme dhe si pasoje është hedhur poshtë si e palejuar. Për këto arsye si dhe bazuar ne dispozitat ligjore te cituara me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr.700/2010 më datën 06.01.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

